

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë civile e shkallës së parë, përmes gjyqtarit Venhar Salihu, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore, sipas padisë së paditësve dhe që të dy nga fshati , Komuna e , të cilët i përfaqëson av. nga , kundër të paditurit nga fshati , Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti kompensimi i dëmit, pas seancës publike me datë 12.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditësve dhe , që të dy nga fshati , Komuna e Prishtinës, e paraqitur kundër të paditurit nga fshati Komuna e dhe **DETYROHET** i padituri që paditësve:

t'i paguajë në emër të dëmit jomaterial dhe material, shumën e përgjithshme prej 3.396.50 €, edhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1.200 €, në emër të frikës, shumën prej 1.100 €, në emër të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 1.050 €, kurse për dëmin material shumën prej 46.50€, kurse për

-Paditësin t'i paguajë në emër të dëmit jomaterial, shumën e përgjithshme prej 2.550.00 €, edhe atë: në emër të dhembje fizike shumën prej 1.100 €, në emër të frikës shumën prej 1.000 €, në emër të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 450 €.

Të gjitha shumat e lartëcekura me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, për dëmin material nga dita e shkaktimit të dëmit, deri në pagesën definitive, kurse për dëmin jomaterial nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, edhe atë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET SI E PA BAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë të paditësve , ku i njëjti përtej shumës së gjykuar ka kërkuar në emër të dëmit jomaterial shumën prej 7.650.00 €, kurse në emër të dëmit material shumën prej 700 €, kurse paditësi , përtej shumës së gjykuar ka kërkuar në emër të dëmit jomaterial shumën prej 1.950 €, kurse në emër të dëmit material, ka kërkuar shumën prej 200 €.

III. DETYROHET i padituri nga fshati , Komuna e , që paditësve dhe që të dy nga fshati , Komuna e t'ia paguaj shpenzimet e kësaj procedure, në shumë të përgjithshme prej 1.461.80 €, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit dhe , të përfaqësuar nga i autorizuari i tyre av. nga , fillimisht më dt. 16.06.2015, në këtë gjykatë, kanë paraqitur padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material, kundër të paditurit nga fsh.

, Komuna e , për shkak se me datë 17.02.2015, rreth orës 12.10 min në fsh.
, Komuna e , pas një mosmarrëveshje gjatë drejtimit të automjeteve u padituri
, ju ka shkaktuar lëndime me dashje trupore paditësve, në atë mënyrë që pasi e
ka tejkaluar veturën e paditësve, ju zë rrugën duke frenuar dhe nga pamundësia e frenimit
e godet në pjesën e pasme veturën e të paditurit, dhe në atë moment i
padituri del nga vetura dhe fillon ta ofendoj me fjalë fyese paditësin , dhe më
pas e godet me grusht në pjesën e fytyrës dhe me këtë rast ia thyen dhembin e perparëm
dhe ia lëndon hundën. Po ashtu, paditesit theksojnë se gjatë kacafytjes i padituri e godet me
shqlem edhe paditesin në këmbën e djathtë me ç'rast i shkakton lëndime të
rënda trupore, ku paditesit pas kësaj janë trajtuar në Qendrën Emergjente të Spitalit
Regjional në Gjilan.

Përfaqësuesi i paditësve, avokati si në padi dhe kërkesëpadi, dhe gjatë
seancave gjyqësore ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkespadi së precizuar me
parashtresën e datës 27.12.2017, me të cilën ka kërkuar që t'i kompenzohen paditësve dëmi
i shkaktuar nga i padituri me datën 17.02.2015, dhe atë per paditesin , në
emër të dëmit jo material , për dhimbje fizike shumë prej 2500 €, për frikën shumë prej
2500 €, për shëmtim trupor shumë prej 2500 €, për zvoglim të aktivitetit të përgjithshëm
jetësor shumë prej 3500 €, pastaj në emër të dëmit material, për ndihmën nga personi i
tjetër shumë prej 200 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 200 €, për shpenzime të
mjekimit shumë prej 46.50 €, për shërim klimateriko-banjos shumë prej 300 €, ndërsa
për paditësin , në emër të dëmit jo material , për dhimbje fizike shumë prej
1500 €, për frikën shumë prej 1500 €, për zvoglim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor
shumë prej 1500 e, pastaj në emër të dëmit material, për ndihmën nga personi i tjetër
shumë prej 100 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 100 €, me kamatë prej 8 % nga
dita e shkakimit të dëmit. Mes tjerash i autorizuari i paditësve i ka kërkuar edhe
shpenzimet e procedurës gjyqësore.

I padituri , ka pranuar aktvendimin për përgjigjen në padi, mirëpo nuk
ka parashtruar përgjigje në padi, ndërsa në sencën për shqyrtim gjyqësor të datës
16.02.2018¹ ka deklaruar se nuk konteston bazën juridike të kërkesëpadi së, mirëpo i njëjti
ka kontestuar lartësin për shumë e llogaritur për kompensimin e dëmit, duke shtuar se i
konteston edhe ekspertizat sa i përket formës së lëndimeve, duke potencuar se në
procedurën penale të zhvilluar ndaj tij për këtë rast ndaj paditësve janë konstatuar lëndime
të lehta trupore e jo lëndime të rënda, ku edhe ka ofertuar me 1000 € për kompenzimin e
dëmit të shkaktuar paditësve.

Provat e administruara

Gjykata për të vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe për të vepruar drejtë në lidhje me
këtë çështje civile-kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Raportin
Mjekësor, nr. prot. 2968, dt.17.02.2015, të lëshuar nga Spitali Regjional i Gjilanit për
; Raportin Mjekësor, nr. prot. dt.17.02.2015, të lëshuar nga Spitali Regjional i
Gjilanit për ; Raportin Mjekësor, dt.18.02.2015, lëshuar nga Ministria e
Shëndetësisë-QKUK, në emër të , Dëftesat e pagesave të datave 18.02.2015,
dt.18.02.2015, dt.19.02.2015, dt. 18.02.2015, dt. 06.03.2015; Kuponi Fiskal, nr.
dt.17.02.2015; Aktgjykimi penal P.nr.261/15, dt.13.03.2015 i Gjykatës Themelore në Gjilan;
Ekspertizat Mjekësore Psikiatrike të ekspertit dt. 03.11.2017 për paditësit

¹ Gjykata të njëjtit i ka dorëzuar disa her ftesa për senaca gjyqësore, por i njëjti për veq semacës së dt.16.02.2018.
nuk ka marrë pjesë në senacat tjera dhe mungesën e tij nuk e ka arsytuar.

dhe , Ekspertizat mjekësore e ekspertit të ortopedisë-traumatolog
dt.06.03.2017, për paditësit : dhe si dhe dëgjimi i
mjekëve dr. dhe dr.

Ekspertizat mjekësore

Dr. , ortoped-traumatolog në konstatimet-gjetjet e tij për paditësin
i ka vërtetuar se i njëjti në mosmarrëveshjen e dt. 17.02.2015 që kanë pasur
me tani të paditurin ka pësuar lëndime të rënda trupore, trauma të
shumëfishta, shtypje në hundë dhe gërvishtje lëkurore, thyerje të dhëmbit, ndrydhje të
diskuseve të qafës, kurse i njëjti ka pasur dhimbje të intenzitetit posaqërisht të lartë 30
minuta, dhimbje të intenzitetit të lartë 1 ditë, intenzitetit të mesëm 10 ditë dhe intenzitetit të
ulët 20 ditë. Gjithashtu, te i njëjti frika primare është paraqitur dhe ka zgjatur disa sekonda e
vazhdon me friken sekondare deri në 3 muaj sa ka zgjat edhe koha e shërimit të tij. I njëjti
ekspert sa i përket paditësi ka konstatuar se nuk ka pasur shëmtim, kurse sa i përket
zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor i njëjti ka pasur 3.75%, e gjithashtu i njëjti në
këtë mosmarrëveshje zvogëlim të aktivitetit të punës nuk ka pasur.

Kurse, sa i përket paditësit , Dr. , ortoped-traumatolog në
konstatimet-gjetjet e tij për këtë paditësi ka vërtetuar se i njëjti në mosmarrëveshjen e dt.
17.02.2015 që kanë pasur me tani të paditurin ka pësuar lëndime të rënda
trupore, trauma të shumëfishta, shtypje në hundë dhe gërvishtje lëkurore, në nëngjurin të
majtë, gjendje pas stendave, ndrydhje të diskuseve të qafës kurse i njëjti ka pasur dhimbje të
intenzitetit posaqërisht të lartë 30 minuta, dhimbje të intenzitetit të lartë 1 ditë, intenzitetit të
mesëm 10 ditë dhe intenzitetit të ulët 20 ditë. Gjithashtu, te i njëjti frika primare është
paraqitur dhe ka zgjatur disa sekonda e vazhdon me friken sekondare deri në 3 muaj sa ka
zgjat edhe koha e shërimit të tij. I njëjti ekspert sa i përket paditësit ka konstatuar se
nuk ka pasur shëmtim, kurse sa i përket zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor i
njëjti ka pasur 1.75%, e gjithashtu i njëjti në këtë mosmarrëveshje zvogëlim të aktivitetit të
punës nuk ka pasur.

Dr. psikiatër-neurolog në ekspertizën mjekësore psikiatrike të tij,
për paditësin ka konstatuar se pas aksidentit në vendin e ngjarjes i njëjti ka
përjetuar frikë si pasojë e gjendjes traumatike-aksidentale në vendin e ngjarjes dhe gjersa i
është dhënë ndihma e parë në emergjencë, e cila manifestohet si frikë primare. I njëjti frikë
primaren të intenzitetit të lartë ka përjetuar 20 minuta dhe pas dhënies së ndihmës së parë
ne emergjencë pason frika sekondare të cilën ka përjetuar paditësi nga frika e lëndimit dhe
pasojat për invalidet të mundshëm. Frikë sekondare të intenzitetit të lartë ka patur dy ditë,
frikë të intenzitetit të mesëm ka pasur 2 javë dhe frikë të intenzitetit të lehtë ka pasur 3
muaj.

Kurse sa i përket paditësit , Dr. psikiatër-neurolog në
ekspertizën mjekësore psikiatrike të tij, për paditësin ka konstatuar se pas
aksidentit në vendin e ngjarjes i njëjti ka përjetuar frikë si pasojë e gjendjes traumatike-
aksidentale në vendin e ngjarjes dhe gjersa i është dhënë ndihma e parë në emergjencë, e
cila manifestohet si frikë primare. I njëjti frikë primaren të intenzitetit të lartë ka përjetuar
20 minuta dhe pas dhënies së ndihmës së parë ne emergjencë pason frika sekondare të
cilën ka përjetuar paditësi nga frika e lëndimit dhe pasojat për invalidet të mundshëm. Frikë
sekondare të intenzitetit të lartë ka patur dy ditë, frikë të intenzitetit të mesëm ka pasur 2
javë dhe frikë të intenzitetit të lehtë ka pasur 2 muaj.

Të njëjtit të dëgjuar në seancën e dt. 19.12.2017, kanë mbetur në tërësi pranë ekspertizave të punuara me shkrim nga ana e tyre pa plotësime dhe ndryshime.

Gjykata ekspertizave-konstatimeve të Dr. _____ dhe Dr. _____ ia fali besimin e plotë, pasi që të njëjtit eksperta kanë një përvojë të gjatë në lëmitë e tyre, si dhe konstatimeve të tyre janë në përputhje të plotë me provat e tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjendja faktike e vërtetuar nga provat e lartëcekura

Nga provat e administruara duke çmuar secilën veç e veç dhe gjitha së bashku ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se me datën 17.02.2015, në fshatin _____, Komuna e Gjilanit, paditësit me të paditurin kanë pasur një mosmarrëvshje lidhur me mënyrën e ngasjes së automjetit, ku i padituri ka sulumuar paditësit dhe të njëjtit kanë kërkuar ndihmë mjekësore pranë Spitalit Regional të Gjilanit, gjithashtu paditësit _____ me datë 18.02.2015 _____ kërkuar ndihmë edhe pranë QKUK-së në Prishtinë (fakte këto të vërtetuara me anë të raporteve të Spitalit Regional të Gjilanit si dhe raportet të lëshuar nga QKUK-ja si dhe aktgjykimi P.nr.261/15, i dt. 13.03.2015).

Nga Aktgjykimi P.nr.261/15, i dt. 13.03.2015 gjykata vërtetoi faktin se i padituri _____ është shpallur fajtor për veprën penale me të cilën e ka akuzuar Prokuroria dhe i njëjti është gjykuar me dënim me gjobë prej 900 euro.

Nga ekspertiza mjekësore ortopedike gjykata vërtetoi faktin se paditësit me dt. 17.02.2015 i padituri i ka shkaktuar lënime të rënda trupore që të dyve. Paditësi _____

ka pasur dhembje të intenzitetit posaqërisht të lartë prej 30 minutave, intenzitetit të lartë 1 ditë, intenzitetit të mesëm 10 ditë dhe intenzitetit të ulët 1 muaj. Gjithashtu nga kjo ekspertizë gjykata ka vërtetuar faktin se padiotësi _____ zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka 3.75% , kurse zvogëlim të aktivitetit të punës nuk ka e gjithashtu nuk ka pasur as shëmtim apo prishje të aspektit estetik, gjithashtu i njëjti ka pësuar nevojë për sghërim fizioterapeutik njëhërë edhe ate 10 ditë. Kurse, nga ekspertiza psikiatrike sa i përket paditësit _____ i njëjti në këtë aksident ka përjetuar frikë të intenzitetit të lartë dy ditë, frikë të intenzitetit të mesëm 2 jave dhe frikë të intenzitetit të lehtë 3 muaj.

Nga ekspertiza ortopedike për paditësin _____ gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka pasur dhembje të intenzitetit posaqërisht të lartë prej 30 minutave, intenzitetit të lartë 1 ditë, intenzitetit të mesëm 10 ditë dhe intenzitetit të ulët 20 ditë. Gjithashtu, nga kjo ekspertizë gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi _____ zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka pasur 1.75%, kurse zvogëlim të aktivitetit të punës nuk ka e gjithashtu nuk ka pasur as shëmtim apo prishje të aspektit estetik, gjithashtu i njëjti nuk ka pasur nevojë. Kurse, nga ekspertiza psikiatrike sa i përket këtij paditësi i njëjti në këtë aksident ka përjetuar frikë të intenzitetit të lartë dy ditë, frikë të intenzitetit të mesëm 2 jave dhe frikë të intenzitetit të lehtë 2 muaj.

Nga fletëpagesa si dhe kuponi fiskal gjykata vërtetoi faktin se paditësi _____ për kontrollat dhe për medikamentet për shërimin e tij ka shpenzuar shumen prej 46.50 euro.

Gjykata, përkatësisht gjyqtari i çështjes pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-ës, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve pjesërisht është e bazuar.

Vendimi i gjykatës

Gjykata duke vërtetuar gjendjen faktike të spjeguar si më lartë, përkatësisht duke vërtetuar se i padituri i ka shkatuar dëm jomaterial paditësve dhe dëm material paditësit në njërën anë, kurse në anën tjetër, duke zbatuar dispozitat e neneve 136 al 1, 137, 140, 179 dhe 183 al.1 dhe 2 të Ligjit të Marëdhënjeve të Detyrimeve vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Kurse sa i përket lartësisë së shumave të gjykuara për dëmin jo material, gjykata u bazua në nenin 323 të LPK-ës, pasi që në rastin konkret baza juridike nuk është kontestuese por vetëm lartësia e kërkesëpadisë e në pamundësi për ta përcaktuar në mënyre të saktë shumat për dëmin jo material dhe material, gjyqtari i çështjes vendosi sipas çmuarje së lirë dhe duke u bazuar në ekspertizat e ekspertëve mjekësore dhe atë ekspertizës së ekspertit të psikiatrise të psikiatrit, Dr. [Emri], dt. 03.11.2017 për paditësin [Emri]: Ekspertizes së ekspertit të ortopedisë, të ortopedit-traumatolog Dr. [Emri], dt.06.03.2017 për paditësin [Emri], Ekspertizës së ekspertit të psikiatrik, të psikiatrit, Dr. [Emri], të dt.03.11.2017 për paditësin [Emri] dhe ekspertizes së ekspertit të ortopedisë, të ortopedit-traumatolog Dr. [Emri], të dt.06.03.2017 për paditësin [Emri], ku me këtë rast detyroi të paditurin që paditësve t'ia paguaj shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit.

Gjykata për paditësin [Emri], për dhimbje fizike të të gjitha intenziteteve gjykoj shumën prej 1.200 €, duke marrë parasysh mendimin e mjekut ortoped të dhënë në ekspertizën e dt. 06.03.2017 si dhe dëgjimin e të njëjtit mjek, në shqyrtimin kryesor të dt.19.12.2017, ku i njëjti ka shpjeguar se paditësi në këtë aksident ka pasur dhimbje të intenzitetit posaqërisht të lartë prej 30 minuta nga momenti i aksidentit deri në marrjen e terapisë adekuate kundër dhimbjes në Qendrën Emergjente në Gjilan, dhimbje të intenzitetit të lartë ka pasur në një ditë, në ditët e ardhshme, kurse dhimbje të intenzitetit të mesëm kanë vazhduar në dhjetë ditë e ardhshme, pasi që i njëjti ka pësuar lëndime të shumfishta, shtypje në hundë dhe gërvishje lëkurore, thyerje të dhembit të parë, ndrydhje të diskuseve të qafës, dhimbje të intenzitetit të ultë paditësi ka pasur një muaj me rradhë, për shkak të natyrës së lëndimeve. Andaj, shuma e gjykuar për shkak të dhimbjeve është në proporcion me natyrën e lëndimeve dhe kohëzgjatjen e këtyre dhimbjeve. Pastaj, në emër të frikës, primare, sekondare, sekondare të intenzitetit të mesëm dhe të ulët, gjykoj shumën e përgjithshme prej 1100 €, duke marrë parasysh mendimin e ekspertit psikiatër të dhënë në ekspertizën e dt. 03.11.2017 dhe duke marrë për bazë kohëzgjatjen e frikës së pësuar, paditësi në ditën e shkakimit të dëmit më datën 07.02.2015, e ku sipas kësaj ekspertize frika primare e intenzitetit të lartë e përjetuar gjatë lëndimit dhe pas lëndimit ka zgjatur 20 minuta, ndërsa frika sekondare e intenzitetit të lartë ka zgjatur 2 ditë, frika e intenzitetit të mesëm ka zgjatur 2 javë, frika e intenzitetit të lehtë ka zgjatur 3 muaj pas aksidentit, dhe si pasojë e kësaj, paditësi në mes të jetës ka përjetuar frikë të vonshme, e cila manifestohet me reprodukimin e situatës aksidentale, gjegjësisht rrezikut, në mënyrë spontane (në gjendje të zgjuar ose në gjumë) si dhe në gjendje të provokuar (gjatë ballafaqimit me situatë të ngjashme). Pastaj, në emër të zvoglimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësorë prej 3.75 %, gjykata gjykoj shumën prej 1.050 €, duke

shpresuar se ky lloj i dëmshpërblimit është një lloj satisfaksioni moral për paditësin, pasi që gjykata ka vëretuar në bazë të ekspertizës mjekësore se në këtë aksident paditësi ka zvogllim të aktivitetit jetësor në shkallë prej 3.75% dhe shuma e gjykuar për shkak të zvogllimit të aktivitetit jetësor, është në proporcion me përqindjen e vëretuar me ekspertizë. Pastaj, në emër të dëmit material për shpenzimet e mjekimit, gjykata gjykoi shumën prej 46.50 €, këtë fakt gjykata ka vërtetuar në bazë të kuponave fiskal të cilat janë adminstruar si prova në shqyrtimin gjyqësorë dhe nga to dëshmohej se paditësi ka hargjuar për barna dhe kontroll shumën e lartëcekur.

Sa i përket paditësit [Emri i paditësit] gjykata vendosi si në dispozitiv që këtij paditësi, i padituri për dëmin jo matërial të paguaj shumën prej 2.550€ dhe atë në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1.100€, në emër të frikës shumën prej 1.000€, në emër të zvogllimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 450€, duke u bazuar në ekspertizat e mjekëve ortoped dhe psikatër, ku të njëjtit përkatësisht ortopedi në konstatimin e tij ka konstatuar se i njëjti ka pasur lëndime të rënda trupore, ka pasur dhimbje të të gjitha llojeve të intensitetit si dhe i njëjti ka pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në lartësi prej 1.75%, andaj gjykata konsideron dhe mendon se ky lloj i dëmshpërblimit është një lloj satisfaksioni moral për paditësin, pasi që gjykata siç thamë më lartë në këtë aksident, ky paditës ka pasur lëndime e cekura më lartë.

Gjykata, të gjitha shumat e lartëcekura i gjykoi me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke u bazuar në nenin 382 par.2 të LMD-së, për dëmin material nga dita e shkakimit të dëmit, deri në pagesën definitive, kurse për dëmin jomaterial nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha në aftat prej 15 ditë nga dita e pranimit të vendimit, nën kërcënimin të përbarimit të dhunshëm.


Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi që ta refuzoj shumën prej 7,650.00€ për dëmin jomaterial të paditësit [Emri i paditësit], kurse shumën prej 1950€ të paditësit [Emri i paditësit], pasi që gjyqtari i çështje ka vlerësuar se kërkesa përtej shumës së gjykuar është shumë e lartë dhe nuk përkon me praktikën tona gjyqësore. Gjithashtu gjykata refuzoi kërkespudinë e paditësit [Emri i paditësit] shumën prej 700€, në emër të dëmit material dhe atë shumën prej 200€, për ndihmën e personit të tretë, shumën prej 300€ për shërim klimaterik. Kurse paditësit [Emri i paditësit] refuzoi shumën për dëmin material, shumën prej 200€ edhe atë shumën prej 100€ për ndihmën nga tjetri si dhe shumën prej 100€ për ushqim të përforcuar, duke u bazuar në nenin 322 të LPK-ës, ku në rastin konkret paditësit gjykatës nuk i ka ofruar asnjë provë materiale me të cilën do të vërtetonte se i njëjtit ka shpenzuar shumë të kërkuara për dëmin matërial si më lartë, në emër të ndihmës së personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar, përkatësisht shërimin klimaterik.

Gjykata vendosi si në pikën III dispozitivit të këtij aktgjykimi që i padituri t'i paguaj shpenzimet gjyqësore të kësaj procedure në shumë të përgjithshme prej 1, 461.80 €, dhe atë: shumën prej 156 € për përpilim të padisë, shumën prej 400 € për Espertizën Mjeksore të punuar nga eksperti Dr. [Emri i ekspertit], dhe ekspertizes së ekspertit, Dr. [Emri i ekspertit], shumën prej 156 për parashtrësën e dt.27.12.2017, shumën prej 608.40 për 3 senaca të mbajtuar (senacat e dt. 09.01.2017, 19.12.2017 dhe 12.03.2018), kurse shumën prej 101.40€ për seancën e dt.24.01.2018,

pasi që kjo seance është shtyer pa fajin e të autorizuarit të paditësve, shumë prej 40€ për pagesën e taksës për dorëzim të padisë të gjitha këto duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-ës, pasi që paditësit janë gjyqfitues në këtë rast kurse i padituri e ka humbur konteëstin. Sa i përket shumave për seancat dhe parashtrirat gjykata i përcaktoi në bazë të TA-së për avokatë në Republikën e Kosovës.

Andaj, gjykata nga të lartëcekuarat, duke përfshirë dispozitat ligjore, bindjes së lirë në nërën anë, kurse në anën tjetër duke u bazuar në nënin 2 lidhur me nenin 143 të LPK-ës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.351/15, dt.12.03.2018

Gjyqtari
Venhar Sahihu


KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.